

**STATUTI I SHOQËRISË TREGTARE
"GREEN MOTION ALBANIA" SH.P.K**

NENI 1

DISPOZITA THEMELORE

Bazuar në legjislacionin në fuqi, kontretisht ligji nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, ligji nr. 9723, datë 03/05/2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" si dhe dispozitat përkatëse të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë si dhe zakonet e mira tregtare, sipas Aktit të themelimit:

- **Nertil Duli, i biri i Edmondit dhe i Anetes, lindur me 13/10/1987 në Gjirokaster dhe banues në Tiranë, në adresën: Rruga "Bektash Kozeli" Nr.6, mbajtës i letërnjoftimit elektronik nr. 033224181, me nr. personal I71013024N**

Me vullnet të lire miratoi "Statutin" për rregullimin normativ të funksionimit të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "GREEN MOTION ALBANIA"sh.p.k, si me poshte:

NENI 2

FORMA DHE SELIA

Shoqëria që do të ushtrojë veprimtarinë në bazë të këtij statuti, do të jetë **shoqëri me përgjegjësi të kufizuar** dhe do të ushtrojë aktivitetin e saj në Republikën e Shqipërisë në bazë të regjistrimit në institucionet tatimore dhe në regjistrat tregëtare shqiptare.

Selia e shoqërisë "**GREEN MOTION ALBANIA**" sh.p.k. është në adresën: **Rruga "Bektash Kozeli" Ndertesa Nr.6, Tiranë, Shqipëri.**

Transferimi i selisë në një adresë tjetër bëhet me vendim të Ortakut të Vetëm, duke u pasqyruar ky ndryshim në regjistrin tregtar.



NENI 3

EMËRTIMI

Për efekt të regjistrimit dhe të gjitha modaliteteve të tjera ligjore shoqëria do të quhet **“Green Motion Albania” Sh.p.k.**

NENI 4

KOHËZGJATJA

Shoqëria **“Green Motion Albania” sh.p.k.** do të ushtrojë aktivitetin e saj për një periudhë të pacaktuar.

Nëpërmjet vendimit të Ortakut të Vetem, zotërues i kapitalit themeltar, aktiviteti i shoqërisë mund të ndërpritet tërësisht dhe menjëherë ose riorganizohet në ç'do kohe, duke bërë ndryshimet në regjistrin tregtar.

NENI 5

OBJEKTI

“Green Motion Albania” Sh.p.k. do të ketë për objekt të veprimtarisë së saj:

- Veprimtari në fushën e dhenies me qera të mjeteve të transportit si makinave, motoreve, minibus, autobus, kamion, mjete lundruese etj.
- Veprimtari në fushën e organizimit të guidave turistike, brenda dhe jashtë vendit.
- Veprimtari në import-eksport, shitjen dhe blerjen e mjeteve motorike.
- Veprimtari në kryerjen e shërbimeve dhe servisit për riparimin dhe mirëmbajtjen e mjeteve motorike.

Nëpërmjet miratimit me vendim të Ortakut të Vetëm, si dhe brenda kufijve të konform modaliteteve të lejuar nga legjislacioni, mund të bëhet ndryshimi, shtimi dhe/ose pakësimi i aktiviteteve që përbëjnë objektin e shoqërisë.



NENI 6

PERSONALITETI JURIDIK

Shoqeria fiton personalitet juridik qe nga koha e regjistrimit te saj.

NENI 7

KAPITALI I SHOQËRISË

Kapitali themeltar i kësaj shoqërie përbëhet nga 10.000 (dhjetë mijë) Lek, dhe perbehet nga 1 (një) kuote, me vlere 10.000 (dhjetë mijë) Lek e cila eshte e depozituar nga Ortaku i vetem ne llogarite shoqerise **"Green Motion Albania" Sh.p.k.**

- Vlera e nje kuote ne shoqerine **"Green Motion Albania" Sh.p.k.** eshte 10.000 (dhjetemije) Lek.
- Ky kapital eshte formuar nga themeluesi i shoqerise duke kontribuar Z. Nertil Duli me 10.000 (dhjetë mijë) Lek, duke zoteruar 100% te kuotave.

NENI 8

SHTIMI I KAPITALIT

Kapitali i shoqerise mund te shtohet sipas rritjes se veprimtarise ekonomike te saj. Fondet monetare do te sigurohen nepermjet veprimtarise te percaktuar ne nenin 5 te ketij statuti.

NENI 9

TRANSFERIMI I KAPITALIT

Transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar për efekt vlefshmërie duhet të bëhet me akt noterial dhe të regjistrohet si në librat e shoqërisë ashtu edhe në QKR.



NENI 10

TRANSFERIMI I KAPITALIT TEK TË TRETËT

Transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar tek të tretët jo ortakë, duhet të miratohet nga Asambleja e zakonshme e Ortakëve, me vendim të shumicës së zotëruesve të kapitalit themeltar.

NENI 11

STRUKTURA

Asambleja e Ortakëve është organi suprem i shoqërisë **“Green Motion Albania” Shpk.**

Ajo përbëhet nga ortaku i vetëm i shoqërisë, i pranishëm në mbledhjen përkatëse.

NENI 12

ADMINISTRIMI

Administrimi i aktivitetit të përditshëm financiar të shoqërisë do të bëhet nga Administratoret e emëruar nga Asambleja sipas përcaktimeve të bëra në statut.

NENI 13

EKSPERTI KONTABËL

Aktiviteti financiar i shoqërisë kontrollohet nga ekspertët kontabël të emëruar nga Ansambleja sipas dispozitave të ketij statuti dhe ligjit.

Nuk është në misionin e eksperetve kontabël të kontrollojnë veprimarinë vendim – dhënëse të Ansamblesë së shoqërisë.

NENI 14

ASAMBLEJA E SHOQËRISË - VENDIMARRJA

Ansambleja e Ortakëve është organi më i lartë vendim-marrës i shoqërisë.

Ajo mbledhet në seanca të zakonshme të paktën çdo një vit.



Mbledhja e zakonshme e Ansamblesë thirret nga Administratori dhe drejtohet me rotacion nga ortakët, ose nga personi i autorizuar prej tyre me vendim të Ansamblesë.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi me shkrim nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë, me vlefshmëri autorizimi vetëm për një mbledhje asambleje, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Njoftimet për mbledhjen e Asamblesë bëhen nga Administratori duke respektuar një afat prej 15 (pesëmbëdhjete) dite nga njoftimi në mbledhje.

Vendimet janë të vlefshme kur votojnë shumica e zakonshme, ndërsa për ndryshimet në statut nga ortakët që përfaqësojnë $\frac{3}{4}$ e pjesëve në kapitalin themeltar.

Vendimet e mbledhjes së ortakëve pasqyrohen në një regjister të vecantë.

NENI 15

PJESMARRJA NË MBLEDHJEN E ASAMBLESE


Në mbledhjet e Ansamblesë mund të marrin pjesë pa të drejtë vote edhe Administratorët e shoqërisë (*kur ky nuk është ortak*), ekspertët kontabël të autorizuar, si dhe çdo person tjetër i thirrur nga organizatorët e mbledhjes për mbarëvajtjen e saj.

NENI 16

VOTIMI

Për marrjen e vendimeve në mbledhjet e Ansamblesë, pesha e votës dhe shumica përcaktohet nga pjesët e kapitalit themeltar të zotëruara nga ortaku votues, apo përfaqësuesi i tij i autorizuar.

Për çështjet që nuk kërkojnë shumicë të cilësuar sipas këtij statuti, vendimet merren kur votojnë në favor ose kundër propozimit ortakë që zotërojnë më shumë se gjysmën e kapitalit themeltar të pranishëm në mbledhje.



NENI 17

KOMPETENCAT E ASAMBLESË

Janë kompetenca ekskluzive të Ansamblesë:

- a. Ndryshimi i dispozitave të Statutit.
- b. Krijimi i filialeve, degeve dhe perfaqesive jashte dhe brenda vendit.
- c. Rritjen apo zvogelimin e kapitalit themeltare
- d. Transferimin e pjeseve te kapitalit themeltare
- e. Veditet që përcaktojnë politikën e drejtimit të shoqërisë.
- f. Emërimi i Administratorit dhe shkarkimi i tij.
- g. Emërimi dhe shkarkimi i Administratorëve të filialeve të shoqërisë.
- h. Miratimin ose mospranimin e propozimeve të Administratorit për kushtet e kontratave të punës për personelin e shoqërisë.
- i. Emërimi dhe shkarkimi i ekspertve kontabël të autorizuar.
- j. Miratimi i Rregullores së Brendshme të shoqërisë dhe ndryshimi i dispozitave të saj.
- k. Miratimi i raportit vjetor të administrimit të shoqërisë.

NENI 18

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

Për drejtimin e aktivitetit të shoqërisë ortakët që zotërojnë një shumicë prej me shume se 1/2 të kapitalit themeltar emërojnë Administratorët, te cilet qëndrojnë në detyrë sipas këtij emërimi për një mandat 5 vjecar me te drejte rizgjedhje.

Administratorët e emëruar mund të jene ortak te shoqërisë, ose persona te tjere te zgjedhur në bazë të aftësive administruese dhe përgatitjes profesionale.


Në vendimin e Ansamblesë për emërimin e Administratorëve, përcaktohen dhe kushtet e kontratës së tij të punës.

Për një mandat 5 vjecar Administrator i shoqërisë do te jete ortaku i vetem **Z. Nertil Duli**.

NENI 19

IDENTIFIKIMI GJATË USHTRIMIT TË AKTIVITETIT

Emri i shoqërisë, i Administratorit apo anëtarëve të Këshillit Administrativ, logo si dhe vula e shoqërisë duhet të figurojë në të gjitha shkresat zyrtare të



shoqërisë si dhe në dokumentat që kanë të bëjnë me përmbushjen e objektit, apo që i shërbejnë ushtrimit të aktivitetit të saj.

NENI 20

PËRFAQËSIMI

Administratori përfaqëson shoqërinë në mardhëniet me të tretët, duke zbatuar politikën e drejtimit të shoqërisë të përcaktuar në bazë të vendimeve të Ansamblesë së Ortakëve,

Në raste të veçanta Administratori mund të autorizoj me prokurë të posaçme konform dispozitave përkatëse të Kodit Civil, një person të tretë, të përfaqësojë shoqërinë.

NENI 21

RAPORTI VJETOR, INVENTARET DHE LLOGARITË VJETORE

Në përfundim të çdo viti financiar Administratori pergatit **Raportin Vjetor të Administrimit**, i cili duhet t'i paraqitet Ansamblesë së Ortakëve për miratim jo më vonë se data 31 Mars e vitit pasardhes nga përfundimi i vitit financiar.

Së bashku me Raportin Vjetor të Administrimit, ortakëve duhet t'ju paraqiten edhe inventaret dhe llogaritë vjetore.

NENI 22


DORËHEQJA E ADMINISTRATORIT

Administratori mund të japë dorëheqje nga funksioni i tij në çdo moment që e quan të arsyeshme duke marrë masa që brenda një muaji nga dorëheqja e tij të organizohet një mbledhje e Ansamblesë për emërimin e një Administratori të ri.

NENI 23

ZBATIMI I VENDIMEVE TË ASAMBLESË NGA ADMINISTRATORI

Për Administratorin në përcaktimin e politikës së drejtimit dhe administrimit të shoqërisë janë të detyrueshme vetëm vendimet e Ansamblesë.



NENI 24

KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT

Administratori ka për kompetencë:

- a. Përfaqësimin e shoqërisë në mardhëniet me të tretët.
- b. Drejtimin e aktivitetit të shoqërisë në bazë të objektit të saj dhe politikës së drejtimit dhe administrimit të përcaktuar në vendimet e Ansamblesë.
- c. Punësimin e personelit të administratës dhe të shërbimit të shoqërisë.
- d. Përcaktimin dhe sanksionimin e kushteve të kontratave të punës për personelin, pas marrjes së miratimit nga Ansambleja.
- e. Thirrjen e mbledhjes së zakonëshme të Ansamblesë së Ortakëve.
- f. Hartimin dhe paraqitjen e Raportit Vjetor të Administrimit të shoqërisë në mbledhjen e Ansamblesë së Ortakëve.

NENI 25

AKTIVITETI DHE KONTROLI FINANCIAR I SHOQËRISË

Viti financiar i shoqërisë **“Green Motion Albania” Sh.p.k.** fillon më datë 1 Janar të çdo viti dhe përfundon më datë 31 Dhjetor po këtij viti.

NENI 26

EMËRIMI I EKSPERTËVE KONTABËL

Me vendim të Ansamblesë për kontrollin e llogarive dhe veprimtarisë së shoqërisë mund të emërohen një ose disa ekspertë kontabël.

Në vendimin e Ansamblesë për emërimin e ekspertëve kontabël të autorizuar përcaktohen:

1. Detyrat,
2. Kufijtë e kompetencës,
3. Kohëzgjatja e emërimit,
4. Masa e shpërblimit,
5. Kur është rasti edhe afati për përgatitjen e raportit të kontrollit.



NENI 27

ZËVËNDËS EKSPERTËT

Në vendimin e Ansamblesë për emërimin e ekspertëve kontabël të autorizuar duhet të përcaktohen edhe një ose disa zëvendës – ekspertë të cilët thirren për të zëvendësuar titullarët në rastet e mospranimit, pengimit, dorëheqjes, shkarkimit apo vdekjes.

Me marrjen e funksionit zëvendës ekspertët kanë të njejtat detyra dhe kufij kompetence të përcaktuara nga vendimi i Ansamblesë për emërimin e ekspertëve.

NENI 28

PJESËMARRJA NË MBLEDHJET E ASAMBLESË E EKSPERTIT KONTABËL


Gjatë mandatit të tij të përcaktuar me vendim të Ansamblesë eksperti kontabël i autorizuar merr pjesë në të gjitha mbledhjet e Ansamblesë, të cilat në rendin e ditës kanë çështje që kanë të bëjnë me detyrat që i janë ngarkuar atij.

NENI 29

SHKARKIMI NGA DETYRA I EKSPERTIT KONTABËL

Eksperti kontabël i autorizuar mund të shkarkohet nga detyra me vendim të Ansamblesë kur:

1. Nuk ka përmbushur detyrat e përcaktuara në vendimin e Ansamblesë për emërimin e tij, brenda afateve të përcaktuara në këtë vendim.
2. Vërtetohet se ka konflikt interesash, pasi personi i emëruar ka lidhje familjare, pune apo të çfarëdolloji tjetër që mund të ndikojnë në kryerjen e detyrës prej tij.
3. Vërtetohet se ka kryer veprime në dëm të shoqërisë apo ka përfituar padrejtësisht nga aktiviteti i shoqërisë.
4. I është hequr e drejta për të ushtruar profesionin e ekspertit kontabël të autorizuar.
5. Ka shkelur sekretin profesional në dëm të shoqërisë.
6. Kur Ansambleja e Ortakëve me një shumicë prej të paktën 3/4^{sh} të zotëruesve të kapitalit themeltar vendos që shërbimi i ekspertit nuk është më i nevojshëm për shoqërinë.



NENI 30

TË ARDHURAT E SHOQËRISË

Të ardhurat e shoqërisë do të vijnë sipas çmimeve që i vendos vete shoqëria, si dhe nga çdo burim tjetër i lejueshëm nga legjislacioni shqiptar. Çmimet dhe tarifatat caktohen sipas kërkesës dhe ofertës.

NENI 31

NDARJA E TË ARDHURAVE

Në përfundim të vitit financiar, pas miratimit të Raportit Vjetor të Administrimit nga Ansambleja e Ortakëve ndahet mes ortakëve në formën e dividendëve fitimi neto i vitit financiar.

Pjesa e fitimit e mbetur pas zbritjeve të mësipërme ndahet në formën e dividendëve mes ortakëve, duke u bazuar për këtë ndarje në përqindjen e pjesëve të kapitalit themeltar që zotëron secili nga ortakët.

NENI 32

MARRËDHËNIET E PUNËSIMIT

Administratori i shoqërisë ka të drejtë të përcaktojë numrin e punonjësve të shoqërisë.

Marrëdhëniet e punësimit brenda shoqërisë behen sipas kontratave që lidhen lirisht midis paleve.

Marrja në punë behet me regjistrimin e punonjësve në librin e punës, si dhe duke njoftuar organet e punësimit të juridiksionit ku ushtron veprimtarinë shoqëria.

Për çështje që nuk parashikohen në kontratë zbatohen dispozitat e kodit të punës.



NENI 33

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Shoqëria **“Green Motion Albania” Sh.p.k.** do të ushtrojë aktivitetin e saj në bazë të këtij statuti apo të ndryshimeve të mëvonëshme të tij për një periudhë të pakufizuar të parashikuar në nenin 4 të Statutit.

NENI 34

Pas vendimit të Ansamblesë apo verifikimit të rrethanave për prishjen e shoqërisë të parashikuara në statut apo ligje, me vendim të Ansamblesë apo të Gjykatës emërohet një likuidator dhe shoqëria hyn në procedurën e likuidimit.

Në vendimin e emërimit të Likuidatorit, Ansambleja përcakton kompetencat dhe kushtet e kontratës së punës të likuidatorit.

NENI 35

Për zgjidhjen e të gjitha mosmarrveshjeve mes ortakëve, për interpretimin e dispozitave të Statutit, të Rregullores së Brendëshme apo të vendimeve të Ansamblesë së Ortakëve kompetente do të jetë Gjykata e vendit ku shoqëria do të ketë selinë, dhe do të aplikohet legjislacioni shqiptar në fuqi.

NENI 36

Ky statut hartohet dhe miratohet sot me datë 14.11.2019, në 4 (kater) kopje të njejta të hartuara në gjuhën shqipe për t'u depozituar në organet kompetente, njëra prej të cilave mbetet pjesë e dokumentacionit të shoqërisë **“ Green Motion Albania” Sh.p.k.**

ORTAKU I VETËM

Z. Nertil Duli

Nertil Duli

